Shoqeria " R & R GROUP"SHPK

.....

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2020

I.Kuadri Kontabel i Aplikuar.

Pasqyrat financiare te periudhes 01.Janar.2020-31.Dhjetor.2020, ne perberje te te cilave jane Bilanci,Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve,Pasqyra e Fluksit te Parase,Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital ne date te mesiperme jane pergatitur ne baze te kerkesave te Ligjit nr.9228 date 29.04.2004"Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare",nenet 4 deri 18 te ketij ligji dhe Standartet Kombetare te Kontabilitetit te vendit tone.

Bilanci ne perberje te pasqyrava financiare tregon pozicionin financiare(aktivet,pasivet dhe kapitalin) te Shoqerise "R & R Group"shpk me date 31.12.2020.

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve tregon perfomancen ekonomike(te ardhurat,shpenzimet dhe fitim/humbjen)te Shoqerise " R & R Group"shpk per periudhen 01.01.2020-31.12.2020.

Pasqyra e fluksit monetar tregon fluksin e parave(Arketimet dhe pagesat ne para dhe ekuivalentet e saj) te Shoqerise" R & R Group"shpk per periudhen 01.01.2020-31.12.2020.

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital tregon ndryshimet ne kapitalin e Shoqerise" R & R Group"shpk shpk per periudhen 01.01.2020-31.12.2020.

I. Informacione te Pergjithshme

1.1 Të dhëna për Shoqërinë

Shoqeria "R & R GROUP"sh.p.k.eshte regjistruara me date 07.02.2008 nga QKB Tirane si shoqeri tregtare.

Selia aktuale eshte Tirane Kamez KAMEZ Lagjja "Valias", Rruga "Skenderbeu". Ndertese Private, Zone Kadastrale Nr.2066, Numer Pasurie 25/13..

Kapitali themeltar I shoqerise eshte bere prej 113,000,000 leke dhe Zoterohet nga Ortaku i vetem Elona Rami 100 % ose 113,000,000 leke.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte Import Export, Shitje me shumice dhe pakice automjetesh dhe pjesesh kembimi te automjeteve, etj.Tregti me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem ushqimore, gaze te lengshme,produkte me origjine shtazore etj.

1.2. Baza e Përgatitjes

Ligji i ri i Kontabilitetit promovon zbatimin ligjore të standarteve nga shoqëritë.

Shoqeria ka vënë në zbatim aplikimin të Ligjit për Kontabilitetin për përgatitjen e Pasqyrave Financiare për periudhën ushtrimore që përfundon më 31 Dhjetor 2020.

Ato përfshijnë standartet e aprovuara nga Keshilli Kombetar I Kontabilitetitt (KKK) dhe interpretimet e standarteve të shpallura nga Ministria e Financave.

Baza e pregaditjes se Pasqyrave Financiare: Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara.(SKK 1,35)

Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdorura per hartimin e pasqyrave Financiare (SKK 1;37-69)

a) NJESIA EKONOMIKE RAPORTUESE ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet, pasivet dhe transaksionet ekonomike te veta.
b) VIJMESIA e veprimtarise ekonomike te njesise sone raportuese eshte e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevoje nderprerjen e aktivitetit te saj.

c) KOMPESIMI midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka , ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet qe lejohen nga SKK
d) KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote per te qene te qarta dhe te kuptushme per perdorues te jashtem qe kane njohuri te pergjitheshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
e) MATERIALITETI eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zerat material
f) BESUSHMERIA per hartimin e Pasqyrave Financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime material duke zbatuar parimet e meposhtme :

- Parimin e paraqitjes me besnikeri
- Parimin e perparesise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
- Parimin e paaneshmerise pa asnje influencim te qellimshem
- Parimin e maturise pa optimizem te teperuar,pa nen e mbivleresim te qellimshem
- Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF.
- Parimin e qendrushmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabel
- Parimin e krahasushmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

Rregullat e Vlerësimit dhe Paraqitjes së Llogarive Vjetore në Shqipëri janë përfshirë në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të vitit 2020.

II . Politikat kryesore kontabele.
Nje permbledhje e pjeses me te madhe te politikave kontabel te aplikuara ne Pasqyrat financiare jane sa me poshte:

2.1. Mjetet Monetare.
Per Mjetet monetare ne arke dhe ne banke eshte aplikuar politika konatabel e vleresimit "Vlera e drejte" ,sipas paragrafit nr.22 te SKK-se nr.3.
Mjetet monetare ne monedha te huaja jane vleresuar ne monedhen baze me kursin e Bankes se Shqiperise qe daton 31.12.2020.

2.2. Aktivet e tjera financiare afatshkurtera.
Per Aktivet e Tjera financiare Afatshkurtera te paraqitura ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2020 eshte aplikuar politika konatabel e vleresimit "Kosto historike minus zhvleresimin e mundshem" ,sipas paragrafit nr.26,27 te SKK-se nr.3.Per vitin aktual vleresimi i tyre eshte bere me vleren nominale ne krijim te tyre.

2.3. Inventari
Per Inventarin e paraqitur ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2020 eshte aplikuar politika konatabel e vleresimit "Kosto historike",sipas paragrafit nr.14,15 te SKK-se nr.4.
Kostoje eshte llogaritur duke perdorur Metoden e mesatares se ponderuar.

2.4.Huat dhe parapagimet.
Per Huat dhe parapagimet te paraqitura ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2020 eshte aplikuar politika konatabel e vleresimit "Kosto e amortizuar" ,sipas paragrafit nr.32,33 te

SHPK IMPORT-EXPORT R&R GROUP TIRANE-ALBANIA

SKK-se nr.3.Vlera nominale e huamarrjeve afatshkurtera eshte amortizuar me kestet e likujdimit ne periudhe.

2.5.Kapitali

Vlera e kapitaleve dhe perberesve te tij eshte vleresuar me vleren e tyre historike kontabel.Ndryshimet ne grupin kapitale kane ardhur jo si rezultat I ndonje SKK-je.

2.6.Te Ardhurat dhe Shpenzimet.

Vleresimi I te Ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere mbi bazen e parimit te konstatimit te drejtave dhe detyrimeve ne momentin e ndodhjes.Vleresimi I tyre eshte bere sipas percaktimeve ne paragrafet 35-37 te SKK-se nr.1 dhe te SKK-se nr.8.

Te ardhurat dhe shpenzimet klasifikohen sipas natyres dhe sipas funksioneve.

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga shitjet neto dhe të ardhurat nga shërbimet të realizuara nga aktivitetet kryesore të shoqerise, duke mos përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH).

Pjesa më e madhe të shitjeve të shoqerise gjenerohen nga shitja e mallrave..

Shpenzimet perfshijne shpenzimet per materialet e konsumuara, si dhe nga shpenzimet e tjera rrjedhese me vleren ne momentin e ndodhjes(parimi i konstatimit te drejtave e detyrimeve)

2.7 Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia ("monedha funksionale"). Pasqyrat financiare paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

III. Informacion-Shtese per zerat Materiale.

3. Mjetet Monetare.

Mjetet monetare jane paraqitur ne bilanc sipas gjendjeve te llogarive bankare ne daten e fundit,31.12.2020, e cila eshte e njejte me ekstratet e fundit te bankave per kete periudhe si dhe me gjendjen e arkes se Shoqerise ne fund muajit Dhjetor 2020.Gjendjet sipas bankave dhe arkes paraqitet .

Gjendja e "Mjetet Monetare" me date 31 Dhjetor 2020 paraqitet:

American bank of investment ne leke	10,789.50
BKT ne leke	2,796,650.55
Credins ne leke	9,938,867.92
Credins Bank ne Euro(72.44)	8.960.84
American bank of investment Dollar (-77.18)	-7,782.84
BKT ne USD (438.86)	44,254.65
Credins Bank ne dollare(1539.23)	155,215.86
Arka	15,994,973.52
SHUMA	**28,941,930 Leke.**

Shoqeria " R & R GROUP"SHPK

.....

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2020

4. Aktivet e tjera financiare afatshkurtera.

Gjendja e "Aktiveve te tjera Financiare Afatshkurtera" me date 31 Dhjetor 2020 paraqitet per shumen **468,204,936 Leke** e cila perfaqson:

-Klientet te faturuar e te pa arketuar 31.12.2020 ne shumen **290,589,739 Leke.**

-Te drejta e detyrime te tjera ne shumen **177,615,197 leke** nga te cilat Tatim fitim i mbipaguar 491,724 leke, TVSH Kreditore ne shumen 733,215 dhe detyrime te tjera 176,390,258 leke te pashlyera deri me 31.12.2020.

5. Inventaret.

Gjendja e "Inventareve" me date 31 Dhjetor 2020 ne paraqitet ne shumen **40,632,565 leke** sipas Innventarit bashkangjitur Pasqurave Financiare.:

6. Aktivet afatgjata materiale.

Gjendja e "Aktivet afatgjata materiale" me date 31 Dhjetor 2020 paraqitet:

Nr	EMERTIMI	Nj.M	Sasia	V/fillestare	Am.akumuluar		Am. vjetor	Vl.e mbetur
2	Furgon Benz	Cope	1	600,000	462,129		0	137,871
3	Ford tourneo	Cope	1	525,618	0		0	525,618
3	ATP Chrysller	Cope	1	160,000	0		0	160,000
4	Kamion Man	Cope	1	1,102,500	0		0	1,102,500
5	Kamion Iveco	Cope	1	248,100	0		0	248,100
	SHUMA Mjete Tranmsporti			**2,636,218**	**462,129**		**0**	**2,174,089**
3	Pirun ngrites	Cope	1	125,000	71,666		0	53,334
4	Shjtylle	Cope	1	14,000	8,146		0	5,854
5	Paisje SistemRuajtje	Cope	1	134,750	65,758		0	68,992
6	Mjet Pirun	Cope	1	93,900	33,804		0	60,096
7	Sistem kamera+alarmi	Cope	1	199,465	58,510		0	140,955
	SHUMA Makineri Pajisje			**567,115**	**237,884**		**0**	**329,231**
8	Rafte metalike	Cope	2	20,052	9,785		0	10,267
9	Rafte metalike	Cope	1	30,835	14,665		0	16,170
10	Kondicionere	Cope	4	128,000	50,176		0	77,824
11	Televizor	Cope	1	83,325	16,665		0	66,660
	SHUMA Pajisje Zyre			**262,212**	**91,291**		**0**	**170,921**
12	Kompjuter	Cope	2	39,998	33,850		0	6,148
13	Kompjuter	Cope	1	25,667	16,170		0	9,497
14	Kompjuter	Cope	1	27,500	0		0	27,500
15	HP	Cope	1	55,833	0		0	55,833
	SHUMA Informatike			**148,998**	**50,020**		**0**	**98,978**
	SHUMA			**3,614,543**	**841,324**		**0**	**2,773,219**

7.Detyrimet afatshkurtera.

Te pagueshme ndaj furnitoreve	337,837,355
Te pagueshme ndaj punonjesve	3,869,003
Detyrimet Sig.shoqerore e TAP	113,262
Tatim ne Burim	6,000
Overdrafte bankare	53,026,895
Detyrime te tjera	12,876,000
SHUMA	**407,728,515**

Detyrimet ndaj Furnitoreve perfaqsojne faturat e materialeve te blera dhe te palikujduara akoma me 31.12.2020.
Detyrimet ndaj punonjesve perfaqsojne pagat e palikujduara deri me 31.12.2020.
Detyrimet ndaj,Sigurime shoqerore,Tap. TVSH e Tatim ne burim perfaqsojne detyrimet e muajt dhjetor 2020 te cilat sipas ligjit paguhen ne Janar 2021.
Overdaftet bankare perfaqsojne overdraftin e marre nga Banka Credins te pashlyer deri me 31.12.2020.
-Te tjera te pagushme perfaqsojne detyrime kreditore te tjera qe jane te pashlyera deri me 31.12.2020.

7.1 Detyrimet afatgjata.

Detyrimet afatgjata ne Shumen **11,901,028 leke** perfaqsojne Kredine bankare te marre ne banka per nevoja te aktivitetit.

8.Kapitali

Gjendja e grupit te Kapitaleve me date 31 Dhjetor 2020 paraqitet:

Kapitali	*31 Dhjetor 2020*
Kapitali Ortakerise	113,000,000
Primi i aksionit	
Njesite ose aksionet e thesarit	
Rezerva ligjore	1,448,936
Rezerva te tjera	5,222,684
Rezerva statuore	
Fitimet e pashperndara	7,728,637
Fitimi/Humbja e vitit financiar	-6,477,150
Totali	**120,923,107**

Kapitali ka ndryshime ne ulje vetem per humbjen vitit 2020 ne per 6,477,150 leke.

Shoqeria " R & R GROUP"SHPK

.....

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2020

9.Fitim/Humbja e Vitit Financiar.

Fitim/Humbja e Vitit Financiar 2020 eshte rezultante e Te ardhurave ushtrimore dhe Shpenzimeve ushtrimore.Ne pasqyren e meposhteme do te paraqitet formula e Fitim/Humbjes te Vitit Financiar 2020.

10.Të ardhurat

Për periudhën kontabël që mbyllet 01 Janar 2020-31 Dhjetor 2020 Shoqeria ka realizuar të ardhura të cilat rrjedhin nga shitja e mallrave shërbimet e kryera.

Te ardhurat e ushtrimit ne vleren 187,647,809 leke kane ardhur :

1.Nga shitja e mallrave e sherbimeve prej	187,617,809 leke.
2.Demshperblime te marra	30,000 leke

11.Shpenzime per Blerje Mallarsh

Shpenzimet per Materialet e konsumuara perfshijne shpenzimet per blerje e mallra gjate vitit 2020 duke shtuar inventarin ne fillim te vitit dhe duke zbritur inventarin ne fund te vitit si me poshte:

Blerje mallra e materiale gjithesej	187,887,253
+Gjendfja e inventarit ne fillim	32,011,079
-Gjendja e inventarit ne fund	40,632,565
Materialet e konsumuara	**179,265,767 Leke.**

12. Shpenzimet e Personelit

Në shpenzimet për personelin, janë përfshirë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore vetem pjesa qe paguan punedhenesi..

Paga punonjesish	3,801,354
Sigurime shoq.e shend.	634,826
Shuma	**4,436,180 Leke.**

13.Shpenzimet e amortizimit.

Shpenzimet e Amortizimit ne shumen **0 leke**.

14.Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Në shpenzimet e tjera te shfrytezimit ne shume **5,734,678 leke** jane perfshire shërbimet e kryera nga të tretët si me poshte:

Trajtime te pergjithshme	179,195
Shpenzime qeraje	480,000
Mirembajtje e riparime	38,745
Siguracione	896,447

Shoqeria " R & R GROUP"SHPK

.....

Shenime Pasqyra Financiare periudha 1 Janar -31 Dhjetor 2020

Te tjera	955,014
Ekspertize e konsulence financiare	40,000
Shpenzime postare e telefoni	152,056
Shpenzime transporti	45,499
Komisione bankare	222,442
Akciza e Taksa doganore	2,152,176
Taksa e tarifa vendore	463,442
Gjoba (Shpenzime te pazbritshme)	109,662

15.Shpenzime Financiare ne shumen 4,688,334 leke perfaqsojne Shenzime per interesat e paguara per vitin 2020 per kredite bankare te marra per nevojat e aktivitetit ne shumen 4,327,127 dhe Humbje nga kembimet valutore ne shume 361,207 leke.

16. Fitimi.

Te ardhurat Gjithesej	**187,647,809 leke.**
Shpenzimet Gjithesej	**194,124,959 leke**
Shoqeria per vitin 2020 ka rezultuar me humbje	**6,477,150 leke .**
Shpenzime te pazbritshme per gjobat	**109,662 leke.**
Humbja fiskale	**6,367,488 leke.**
Tatim fitimi per vitin 2020 eshte	**0 leke**
Humbja neto i shoqerise eshte	**6,477,150 leke.**

17.Ngjarjet pas datës së bilancit kontabël

Ngjarje te tjera mbas dates se bilancit, te cilat mund te kishin ndikim ne rezultatin financiar te shoqerise per periudhen Janar-Dhjetor 2020, nuk ka.

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Jonuz Muça

Per Drejtimin e Njesise Ekonomike

Administratori

Lulzime RAMI

Tirane me 10 Mars 2021 .